



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 konform edhe Udhëzuesit të përgjithshëm të MASHT për organizimin e procesit mësimor në vitin shkollor 2021/2022 në kushte të pandemisë covid-19, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM
PËR FORMIMIN E TASK FORCËS NË NIVEL TË DREJTORATIT KOMUNAL PËR
ARSIM

Neni 1
Përbërja

Formohet, TASK FORCA në nivel të DKA-së për organizimin e procesit mësimor në vitin shkollor 2021/2022 në kushte të pandemisë COVID-19, në përbërje si vijon:

1. Rasim Hasani –Drejtore i DKA-së, Kryesuese
- 2.Driton Sadiku-drejtore i shkollës “Ismajl Luma” Lipjan, anëtar
- 3.Jakup Bahtiri- drejtore shkollës “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan, anëtar
- 4.Semir Gashi-drejtore Gjimnazit “Ulpiana” në Lipjan, anëtar
5. Teuta Berisha - zyrtare e DKA, anëtare.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Task Forcës

Task Forca ka detyrë dhe përgjegjësi ti zbatojë dispozitat e Udhëzuesit të përgjithshëm të MASHT për organizimin e procesit mësimor në vitin shkollor 2021/2022 në kushte të pandemisë covid-19 dhe kryesisht kryen detyrat si vijon:

1. Mban mbledhje të rregullta për vlerësim të situatës në nivel të komunës (së paku një herë në muaj);
2. Harton raporte të rregullta për Task Forcën në MASHTI;
3. Monitoron zbatimin e skenarëve në nivel të komunës;
4. Analizon raportet nga secila Task Forcë në IEAA (Institucionet edukative arsimore dhe aftësuese)
- 5.Monitoron zbatimin e masave në nivel të IEAA të përcaktuara në protokollin e COVID-19;

6.Përpilon plan të zëvendësimit të pjesëtarëve të personelit që mungojnë në bashkëveprim me Task Forcën në IEAA .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Task Forcës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.620-35959 i datës 12.08.2020 për formimin e grupit punues për përgaditjen e fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021.

1Nr. 610 - 7670

Lipjan, më 09.02-2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

